



FTESË PËR MEDIA

Agjencia Kundër Korrupsionit ka kënaqësinë t'ju ftojë në hapjen e punimeve të Konferencës Rajonale Kundër Korrupsionit të enjten, më 4 tetor 2018, në Hotelin Swiss Diamond në Prishtinë, me fillim në ora 09:30.

Në Konferencën dyditore (4 dhe 5 tetor) marrin pjesë drejtues të institucioneve relevante nga Shqipëria, Bosnja e Hercegovina, Italia, Kroacia, Mali i Zi, Moldavia, Turqia, përfaqësues nga organizatat të specializuara ndërqeveritare në nivel rajonal dhe më gjerë (UNDOC, OECD, UNDP), ekspertë ndërkombëtarë nga sfera e parandalimit dhe luftimit të korrupsionit, si dhe përfaqësues të institucioneve vendore për rend dhe ligj, dhe të organizatave të shoqërisë civile.

Në hapjen e punimeve të Konferencës do të marrin pjesë drejtues të institucioneve shtetërore dhe përfaqësues të korpusit diplomatik në Kosovë.

Konferenca Rajonale Kundër Korrupsionit është e para këtij formati që organizohet në Kosovë dhe synon që të bëhet tradicionale përmes miratimit të një Deklarate të Përbashkët në përmbyllje të punimeve.

Konferenca ka për qëllim që të kontribuojë në forcimin e bashkëpunimit rajonal në Europën Juglindore përmes shkëmbimit të përvojave dhe praktikave të mira në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Në faqen pasuese të kësaj ftese mund gjeni programin e Konferencës dhe profilet (biografite e shkurtra) të folësve kyç në Konferencë.

Për informata më të detajuara përkitazi me aranzhimet për mbulimin medial të kësaj ngjarje jeni të lutur që të kontaktoni personin përgjegjës për media:

Sali Salihu

sali.salihu@rks-gov.net

+383 38 518 980 lok. 10737

AGJENDA

Konferenca Rajonale Kundër Korrupsionit Të arriturat, sfidat dhe rruga përpara

4-5 tetor, 2018
Prishtinë

Dita I: 4 tetor, 09:00 – 14:00

09:00 – 9:25

REGJISTRIMI

09:25 – 09:30

FJALIMI HYRËS

z. Shaip Havolli, Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

09:30 – 09:50

FJALIMET HYRËSE

SH.T z. Hashim Thaçi, President i Republikës

znj. Albulena Haxhiu, Kryesuese e Komisionit parlamentar për legjislacion, mandate, imunitete dhe mbikëqyrje të Agjencisë Kundër Korrupsionit

znj. Nataliya Apostolova, Përfaqësuesja Speciale e BE-së në Kosovë

z. Jean-Hubert Lebet, Ambasador i Zvicrës,

z. Ruairí O'Connell, Ambasador i Mbretërisë së Bashkuar,

z. Piero Cristoforo Sardi, Ambasador i Republikës së Italisë

znj. Ulrika Richardson, Përfaqësuesja Rezidente e UNDP-së në Kosovë

09:50 – 10:30

TË ARRITURAT, SFIDAT DHE RRUGA PËRPARA PËR EUROPËN JUGLINDORE

Folësit kryesorë

z. Drago Kos, Kryesues i Grupit Punues të OECD-së Kundër Mitos

z. Luca Trifone, Autoriteti Kombëtar Italian Kundër Korrupsionit

Moderator: Veli Hoti, Këshilltar ligjor

10:30 – 11:00

Foto Grupore & Pushim për kafe

11:00 – 12:30

Seanca I:

SFIDAT RAJONALE: ZOTIMET E SHTETEVE PËR BASHKËPUNIM RAJONAL NË

PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E KORRUPSIONIT

Folësit:

z. Shaip Havolli, Drejtor i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit,

z. Flori Karaj, Institucioni i Lartë për Deklarimin e Pasurive dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Shqipëri

z. Hasim Šabotić, Drejtor i APIK-ut, Bosnjë dhe Hercegovinë

z. Plamen G. Dimitrov, Kryesues i Komisionit për Parandalimin dhe Konstatimin e Konfliktit të Interesit, Bullgari

znj. Nataša Novaković, Kryetare e Komisionit për zgjidhjen e konfliktit të interesit, Kroaci

z. Mlladen Tomoviq, zëvendës drejtor në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Mali i Zi
znj. Berna Ozcan Genc, Gjyqtare Raportuese, Turqi

Temat:

- Bashkëpunimi midis agjencive kundër korrupsionit dhe atyre ligj-zbatuese;
- Procesi i Berlinit – Samiti i Londrës (2018) – Samiti i Triestes (2017);
- Drafti i Traktatit Ndërkombëtar për Këmbimin e të dhënave për qëllime të deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit;

Diskutim i hapur

Moderator: Veli Hoti, Këshilltar ligjor

12.30 – 14.00

Dreka

14.00 – 18.30

Aktivitet kulturor për mysafirët nga jashtë

Vizitë qytetit dhe monumenteve kulturore dhe historike

Dita II: 5 tetor, 09:00 – 15:00

09.00 – 10.00

Seanca II:

DEKLARIMI I PASURIVE DHE ASETIVE NGA ZYRTARËT E LARTË PUBLIK

Folës:

z. Irakli Kotetishvili, Specialist i Politikave për administratë publike dhe kundër-korrupsion, UNDP Stamboll

znj. Evgjeni Bashari, Institucioni i Lartë Shqiptar për Deklarimin e Pasurive

Temat:

- Bashkëpunimi me agjencitë e zbatimit të ligjit, NJIF-ët
- Sfidat në monitorimin e pasurive të deklaruara
- Efikasiteti i sanksioneve penale dhe administrative

Diskutim i hapur

Moderator: Afrim Atashi, Drejtor i Departamentit për Parandalimin e Korrupsionit

10.00 – 11.00

Seanca III:

KONFLIKTI I INTERESIT

Folësit:

z. Drago Kos, Kryesues i Grupit Punues Kundër Ryshfetit (OECD)

z. Frashër Murtezaj, Shef i Divizionit të Konfliktit të Interesit, Agjencia Kundër Korrupsionit

z. Edmond Dunga, Projekti PECK II i Këshillit të Europës

z. Vladica Babić, Përfaqësues i APIK-ut, Bosnjë dhe Hercegovinë

Temat:

- Ndëshkimet administrative dhe penale

- Ngritja e vetëdijes
- Sfidat në fushën e prokurimit publik, procedurat e përzgjedhjes dhe emërimit të zyrtarëve publik

Diskutim i hapur

Moderator: Frashër Murtezaj, Udhëheqës i Divizionit të Konfliktit të Interesit

11.00 – 11.30

Pushim për kafe

11.30 – 12.30

*Seanca IV: **Strategjitë dhe Politikat Kundër Korrupsionit dhe Planet e Integritetit***

Folësit:

z. Mato Meyer, Specialist teknik UNDP SAEK

z. Constantine Palicarsky, Zyrtare e drejtësisë Parandaluese dhe Penale, UNODC

znj. Nataša Novaković, Përfaqësuesi i Komisionit për Zgjidhjen e Konfliktëve të Interesit, Kroaci

Temat:

- Monitorimi i zbatimit dhe vlerësimi i progresit
- Përcaktimi i prioritetëve

Diskutim i hapur

Moderator: Blerim Kelmendi, Drejtori i Departamentit për Hetime në Agjencinë Kundër Korrupsionit

12.30 – 13.30

Dreka

13.30 – 15.00

SHËNIMET PËRMBYLLËSE DHE MIRATIMI I DEKLARATËS SË PËRBASHKËT

Folësit:

z. Shaip Havolli, Drejtor i Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit,

z. Flori Karaj, Institucioni i Lartë për Deklarimin e Pasurive dhe Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Shqipëri

z. Hasim Shabotiq, Drejtor i APIK-ut, Bosnjë dhe Hercegovinë

z. Plamen G. Dimitrov, Kryesuesi i Komisionit për Parandalimin dhe Konstatimin e Konfliktit të Interesit, Bullgari

znj. Nataša Novaković, Kryetare e Komisionit për zgjidhjen e konfliktit të interesit, Kroaci

z. Mlladen Tomović, zëvendës drejtor në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Mali i Zi

znj. Berna Ozcan Genc, Gjyqtare Raportuese, Turqi

Moderator: Veli Hoti, Këshilltar ligjor

FOLËSIT KYÇ

Konferenca Rajonale Kundër Korrupsionit

4-5 tetor, 2018

Prishtinë

z. DRAGO KOS – Folës kyç në Sesionin III mbi konfliktin e interesit

Drago Kos është aktualisht Kryesues i Grupit Punues të OECD-së mbi Ryshfetin në Transaksionet e Bizneseve Ndërkombëtare, Bashkë kryesues i MENA-s, Rrjetit të Integritetit të Bizneseve të OECD-së, anëtar i Bordit Ndërkombëtar Këshillues Kundër Korrupsionit (IACAB) dhe i Komisionit të Monitorimit të Korrupsionit (NAKO) në Ukrainë si dhe këshilltar i Agjencisë Kundër Korrupsion të Kosovës. Në periudhën midis viteve 2011 dhe 2015, ai ishte Komisionar Ndërkombëtar dhe Kryesues i Komisionit të Përbashkët të Pavarur për Mbikëqyrjen dhe Vlerësimin e përpjekjeve Kundër Korrupsion (MEC) në Afganistan. Midis viteve 2003 dhe 2011, ai ishte Kryesues i Këshillit të Grupit të Shteteve të Evropës kundër Korrupsionit (GRECO).

z. IRAKLI KOTETISHVILI – Sesioni II Asetet e Zyrtarëve Publik dhe Deklarimi i të Hyrave

Irakli Kotetishvili është Specialist në fushën Kundër Korrupsion dhe Administratë Publike në Zyrën Rajonale të UNDP-së në Stamboll, me fokus në reformat në Evropë si dhe në nën-rajonet e Azisë Qendrore. Angazhimet e tij në të kaluarën përfshijnë Bankën Botërore, OSBE-në dhe DFID-in në fushën e kundër korrupsionit, administratën publike dhe reformat në deklarimin e asetëve në Ukrainë, Armeni, Ugandë, Moldavi, Kazakistan dhe Etiopi. Para karrierës së tij ndërkombëtare, ai ka punuar si Drejtor i Byrosë së Shërbimit Civil në Gjeorgji, ku dhe ka zbatuar Sistemin e Deklarimit të Aseteve në vitin 2010. Irakli ka magjistraturë në Juridik nga Universiteti i Suseksit (SHBA) dhe Magjistraturë në Politikat Publike nga Universiteti i Oksfordit. Ai flet gjuhën angleze, gjeorgjiane, ruse dhe franceze.

z. MATO MEYER – Sesioni IV Strategjitë dhe politikat kundër korrupsionit, dhe, planet e integritetit

Që nga gushti i vitit 2016, Mato Meyer është Specialist i Lartë për kundër korrupsion në UNDP. Para kësaj pozite, Z. Meyer ishte emëruar në Sekretariatit e OSBE-së për Evropë në Vjenë, ku ka shërbyer si zyrtar përgjegjës për programin kundër shpëlarjes së parave dhe financimit të terrorizmit, si dhe fushës së kundër korrupsionit. Ai ka shërbyer si përfaqësues në Task Forcën për Veprim Financiar (FATF), në Moneyval të Këshillit të Evropës, Grupin Egmont të Njërive të Inteligjencës Financiare si dhe Grupin Euroaziatik (EAG). Ka pesëmbëdhjetë vjet përvojë në këshillime politike, hartim legjislativ dhe trajnim të specializuar lidhur me fushën e kundër korrupsionit në Evropë dhe në Azinë Qendrore me OSBE-në dhe UNDP-në. Z. Meyer ka magjistraturë nga Universiteti Yale, si dhe baçelor nga Shkolla për Shërbim të Jashtëm në kuadër të Universitetit Georgetown.

z. CONSTANTINE PALICARSKY – Sesioni IV Strategjitë dhe Politikat Kundër korrupsionit-Korrupsion

Constantine Palicarsky është Zyrtar për Parandalimin e Korrupsionit dhe për Drejtësi Penale në Seksionin për Mbështetje të Zbatimit, në kuadër të Degës kundër Korrupsionit

dhe Degës së Krimeve Ekonomike, në Zyrën e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimeve (UNODC). Z. Palicarsky është pjesë e ekipit të vendosur në Vjenë si dhe në terren, dhe është përgjegjës për t'u ofruar mbështetje teknike shteteve të ndryshme gjatë përpjekjeve të tyre në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, në bazë të Konventës Ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit. Është jurist me më shumë se 20 vjet përvojë në zbatimin dhe udhëheqjen e projekteve kundër korrupsionit në shërbimin civil, organizata qytetare si dhe këshilltar në një varg programesh të BE-së dhe Kombeve të Bashkuara. Përvoja ndërkombëtare e Z. Palicarsky mbulon Evropën Qendrore dhe Lindore, ish Bashkimin Sovjetik, Paqësorin, Afrikën, Azinë Qendrore dhe rajonin e Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut, me fokus në parandalimin e korrupsionit, mbështetjen e agjencive kundër korrupsion dhe ndërtimin e kapaciteteve.

z. LUCA TRIFONE

Luca Trifone (1968) është ekspert i marrëdhënieve ndërkombëtare me një përvojë të gjatë ndërkombëtare në diplomaci. Pas marrjes së diplomës universitare në drejtësi nga Universitetit të Salernos (Itali) ai nisi karrierën si Ligjërues Asistent në Katedrën e Juridikut të Bashkimit European (1992-1997). Në vitin 1997 z. Trifone nisi karrierën e tij diplomatike me ç'rast ka mbajtur një sërë funksionesh të larta, si: Konsull në Konsullatën e Përgjithshme [të Italisë] në Shtutgart, Sekretar i Parë e pastaj edhe Konsull në Pekin, Shef i Drejtoratit të Përgjithshëm për Politikat e Migrimit, Shef i Drejtoratit Çështje Globale dhe Globalizim, dhe Këshilltar në Ambasadë. Që nga viti 2016 z. Trifone shërben si Ekspert i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Autoritetin Kombëtar [italian] Kundër Korrupsionit (Autorità Nazionale Anticorruzione).
